



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:158691

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06343705

2021:158692

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.Z nga Ferizaj, rr.”...”, p.nr, me nr. personal ..., të cilën e përfaqëson av. Rafiz Shehu nga Ferizaj, kundër të paditurit B.Q Sh., nga Ferizaj rr.”...” nr.135, me objekt kontesti lirim prone, vlera e kontestit e pacaktuar, jashtë seance me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia me shenjën 2021:158692, e paditëses B.Z nga Ferizaj, kundër të paditurit B.Q Sh., nga Ferizaj, me objekt kontesti lirim prone, vlera e kontestit e pacaktuar.

A r s y e t i m

Paditësja, të cilën e përfaqëson av. Rafiz Shehu nga Ferizaj ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 19.07.2021, kundër të paditurit, për çështjen objekt kontesti lirim prone.

Përfaqësuesi i paditëses av. Rafiz Shehu nga Ferizaj me parashtrësën e dt.23.10. 2024, e ka njoftuar gjykatën se paditësja pas konsultimeve me të si përfaqësues ka shprehur dëshirë për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridike. Meqë në gjykatë nuk ka mbërritur përgjigja në padi e të paditurit, gjykata nuk ia dërgoi parashtrësën e paditëses për deklaram të njëjtit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm

Datë 24.10.2024

Gj y q t a r i,
Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.